VENDIM
Nr. 168, datë 2.11.2020

MBI KËRKESËN PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 146, DATË 10.9.2020, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "SEKA HYDROPOWER" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et "SEKË", ME KAPACITET TË INSTALUAR 12667 kw DHE "ZAIS", ME KAPACITET TË INSTALUAR 2295 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 14962 kw

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 92, të "Kodit të procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", si dhe nenit 16, pikat 1, 2 dhe 3, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 116/8 prot., datë 2.10.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi rishikimin vendimit të Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, "Mbi licencimin e shoqërisë "Seka Hydropower" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrik,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 146, datë 10.9.2020, vendosi: 1. Të licencojë shoqërinë "Seka Hydropower" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: "Sekë", me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe "Zais", me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total 14962 kw, për një afat 28-vjeçar.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1140 prot., datë 1.10.2020, është paraqitur nga përfaqësuesja me prokurë të posaçme znj. Dorina Ndreka, e komunitetit të zonës ku po zhvillohet projekti i HEC-ve "Sekë" dhe "Zais", kërkesa për rishikimin e tij.
- Gjatë shqyrtimit të kësaj kërkese, rrethanave e fakteve të paraqitura në të, me *email*-in e datës 22.10.2020, protokolluar në ERE, me nr. 1134 prot., datë 22.10.2020, administratori i shoqërisë "Seka Hydropower" sh.p.k. ka kërkuar që të njihet me këtë kërkesë për rishikimin e vendimit nr. 146/2020, me qëllim që të mundësohet dhe dërgimi i informacionit të nevojshëm nga ana e shoqërisë.
- Në vijim, me shkresën nr. 1134/3, datë 30.10.2020, ERE i ka dërguar shoqërisë "Seka Hydropower" sh.p.k., dokumentacionin shoqërues mbi të cilin kërkuesi ka mbështetur kërkesën për rishikimin e vendimit nr. 146/2020, për t'u njohur dhe i ka kërkuar që brenda 3 ditësh të depozitojë në ERE çdo informacion apo dokumentacion që shoqëria beson se mund të argumentojë një qëndrim për të pretenduar rrëzimin e kërkesës së kërkuesit, nëse e disponon.
- Me qëllim marrjen e informacionit nga i licencuari, si dhe nga institucionet kompetente, në lidhje me statusin e zonës ku po ndërtohen HEC-et "Sekë" dhe "Zais", në zbatim dhe të nenit 92 të Kodit të Procedurave Administrative, që ka parashikuar mundësinë e zgjatjes së afatit të një procedure, për sa kohë është e nevojshme, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar, ERE ka të drejtë të zgjasë afatet për shqyrtimin e kësaj kërkese për rishikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Zgjatjen me 30 (tridhjetë) ditë të afatit të vendimmarrjes së Bordit për shqyrtimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10. 9.2020.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti